



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 45

Tiranë – E premte, 10 mars 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 19/2017 datë 23.2.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit për zhvillimin e integruar urban dhe të turizmit..... 2865
Ligj nr. 20/2017 datë 23.2.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, “Huamarrësi”, dhe KfW Frankfurt am Main, “KfW”, për programin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, rajoni Vlorë..... 2876



**LIGJ**  
**Nr. 19/2017**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË  
HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE BANKËS  
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM  
DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E  
PROJEKTIT PËR ZHVILLIMIN E  
INTEGRUAR URBAN DHE TË  
TURIZMIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit për zhvillimin e integruar urban dhe të turizmit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.2.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10061, datë 6.3.2017,  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

NUMRI I HUAS \_\_\_\_\_-AL  
**MARRËVESHJE HUAJE**  
(PROJEKT PËR ZHVILLIMIN E  
INTEGRUAR URBAN DHE TË  
TURIZMIT)NDËRMJET REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE BANKËS  
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE  
ZHVILLIM E DATËS \_\_\_\_\_ 2016

NUMRI I HUAS \_\_\_\_\_AL  
**MARRËVESHJE HUAJE**

Marrëveshje e lidhur në datën \_\_\_\_\_  
2016 ndërmjet Republikës së Shqipërisë

(Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), me anë të së cilës Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

**Neni I**

**Kushte të përgjithshme; përkufizime**

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç janë përcaktuar në aneksin e kësaj Marrëveshjeje) janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e shkruar me germa kapitale që përdoren në këtë Marrëveshje, kanë kuptimet që iu jepen atyre të Kushtet e Përgjithshme apo aneksi i kësaj Marrëveshjeje.

**Neni II**

**Huaja**

2.01 Banka bie dakord që t'i japë Huamarrësit, me kushtet dhe afatet që parashikohen apo përmenden në këtë Marrëveshje, shumën prej gjashtëdhjetë e tre milion e tetë qind mijë euro (63,800,000 euro) (Huaja), për të dhënë asistencë në financimin e projektit, një përshkrim i të cilit jepet në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Huamarrësi mund t'i tërheqë të ardhurat nga Huaja në përputhje me seksionin IV të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa "Fillim-mbarim" (*front-end*) që paguan Huamarrësi është e barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) të shumës së huas.

2.04 Tarifa e angazhimit që paguan Huamarrësi është e barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) në vit të shumës së patërhequr të huas.

2.05 Interesi që paguan Huamarrësi për çdo periudhë interesi është në përqindje të barabartë me normën e referencës për monedhën e huas plus marzhin fiks. Pavarësisht sa më sipër, nëse ndonjë shumë e balancës së tërhequr të huas mbetet e pa paguar kur bëhet e pagueshme, dhe kjo mospagesë vazhdon për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh, atëherë interesi i pagueshëm nga Huamarrësi do të llogaritet siç përcaktohet në seksionin 3.02 (e) të kushteve të përgjithshme.

2.06 Datat e pagesës janë datat 1 prill dhe 1 tetor të çdo viti.

2.07 Shuma e principalit të huas shlyhet në përputhje me afatin e shlyerjes që parashikohet në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje.



### Neni III Projekti

3.01 Huamarrësi shpall angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, bën të mundur që Projekti të zbatohet nga Enti Zbatues i Projektit në përputhje me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme dhe me Marrëveshjen e Projektit.

3.02 Pa u kufizuar në dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, dhe përveç kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi garanton që Projekti të zbatohet në përputhje me dispozitat e shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

### Neni IV Kompensimi i Bankës

4.01 Ngjarja shtesë e pezullimit konsiston si më poshtë, sipas së cilës, legjislacioni që rregullon Entin Zbatues të Projektit është amenduar, pezulluar, abroguar, shfuqizuar ose nga ai është hequr dorë, në mënyrë që dëmton ndjeshëm dhe negativisht aftësinë e Entit Zbatues të Projektit për të zbatuar çfarëdo detyrimi të tij në bazë të Marrëveshjes për Projektin ose Marrëveshjes së Kanalizimit.

4.02 Ngjarja shtesë e përshpejtimit konsiston si më poshtë, sipas të cilës, çdo rast që është përcaktuar qartë në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje, ndodh dhe vazhdon për një periudhë prej 60 ditësh pasi Banka i jep njoftim Huamarrësit për rastin.

### Neni V Efektiviteti; përfundimi

5.01 Kushtet shtesë të efektivitetit konsistojnë si më poshtë:

a) Marrëveshja e kanalizimit, e pranueshme për Bankën, është nënshkruar në emër të Huamarrësit dhe Entit Zbatues të Projektit.

b) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, ka bërë të mundur që Enti Zbatues i Projektit të përgatisë dhe miratojë një Manual Operacional të Projektit, të pranueshëm për Bankën.

c) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, ka bërë të mundur që Enti Zbatues i Projektit, për sa i takon Njësisë për Koordinimin e Projektit në Ministrinë e Zhvillimit

Urban, të punësojë një staf me kualifikime dhe përvojë dhe sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën.

5.02 Çështja shtesë ligjore konsiston si më poshtë, sipas të cilës Marrëveshja e kanalizimit është autorizuar rregullisht nga Huamarrësi dhe Enti Zbatues i Projektit, dhe përbën detyrim ligjor për Huamarrësin dhe Entin Zbatues të Projektit në përputhje me kushtet e saj.

5.03 Afati i bërjes efektive është data nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

### Neni VI Përfaqësuesi; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i tij i Financave.

6.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”  
Tiranë  
Shqipëri  
Faks: +355 4 22 28494

6.03 Adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development  
1818 H Street, N.W.  
Washington, D.C. 20433  
United States of America  
Teleks: Faks:  
248423(MCI) ose 1-202-477-6391  
64145(MCI)

Palët ranë dakord më \_\_\_\_\_, duke filluar nga dita dhe viti që shënohet fillimisht më lart.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

nga \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: \_\_\_\_\_

Titulli: \_\_\_\_\_

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR  
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

nga \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: \_\_\_\_\_

Titulli: \_\_\_\_\_



## SHTOJCA 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Objektivat e Projektit janë: (a) përmirësimi i infrastrukturës urbane; (b) shtimi i aseteve për turizmin; dhe (c) fuqizimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur turizmin në lidhje me zhvillimin ekonomik vendas të zonave të përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Projekti konsiston në këto pjesë:

Pjesa 1: Zhvillimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës

Modernizimi i infrastrukturës në Bashki të Përzgjedhura me anë të: (a) përgatitjes së studimeve paraprake dhe projekteve (duke përfshirë studimet për projekte urbane); (b) kryerjes së punimeve ndërtimore për restaurimin e godinave të përzgjedhura me vlerë historike; (c) zhvillimit të hapësirave publike, rrjetit rrugor dhe infrastrukturës bashkëshoqëruese; dhe (d) kryerjes së mbikëqyrjes së ndërtimeve.

Pjesa 2: Zhvillimi i zonave turistike

Përmirësimi i zonave të përzgjedhura turistike përgjatë jugut të Korridorit Turistik të Shqipërisë, mes të tjerash: (a) duke restauruar asetet e përzgjedhura të turizmit të orientuar në trashëgiminë dhe të turizmit kulturor, dhe duke krijuar zona pushimi ose pika turistike; (b) duke riparuar e përmirësuar infrastrukturën e zonave turistike, si rrugët për këmbësorë; (c) duke përgatitur studimet e nevojshme paraprake, planet për menaxhimin e zonave turistike dhe projektet inxhinierike; dhe (d) duke kryer mbikëqyrjen e ndërtimeve.

Pjesa 3: Zhvillimi i tregut dhe i produkteve të turizmit

a) Fuqizimi i kapaciteteve të bashkive për kryerjen e shërbimeve bashkiake, mes të tjerash, përmes: (i) sigurimit të sistemeve për menaxhimin e aseteve, sistemeve të informacionit gjeografik dhe pajisjeve për grumbullimin e mbetjeve të ngurta; dhe (ii) krijimit të aftësive menaxheriale të zonave turistike për përmirësimin e aktivitetit të aseteve të rehabilituara.

b) Kryerja e veprimtarive për rritjen e kapaciteteve, me qëllim fuqizimin e kapaciteteve të:

i) Bashkive të përzgjedhura për të nxitur zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, duke përfshirë: (A) përpilimin dhe zbatimin e strategjive për kërkimet në treg dhe krijimin e produkteve, dhe

(B) krijimin e partneriteteve pilot për menaxhimin në destinacion;

ii) Agjencive shtetërore qendrore pjesëmarrëse, me qëllim nxitjen e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, duke përfshirë ngritjen e një sistemi për monitorimin e treguesve të turizmit të qëndrueshëm.

Pjesa 4: Mbështetja për zbatimin

Sigurimi i mbështetjes për realizimin e zbatimit të Projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e sistemit për monitorimin dhe vlerësimin e Projektit, si dhe trajnimi dhe financimi i kostove operative rritëse.

## SHTOJCA 2 ZBATIMI I PROJEKTTIT

Seksioni I. Masat institucionale dhe masat për zbatim

A. Masat institucionale

1. Njësia për Koordinimin e Projektit dhe Ministria e Zhvillimit Urban

1. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban:

a) mban gjatë gjithë kohës së zbatimit të Projektit Njësinë e tij për Koordinimin e Projektit (NJKP), stafi kryesor i së cilës ka në përbërje një urbanist, një specialist të turizmit dhe një arkitekt, të gjithë këta me kualifikime dhe përvojë dhe sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën; dhe

b) garanton që NJKP-ja e tij të kryejë mbikëqyrjen e Projektit dhe bashkërendimin e kontributeve teknike të Bashkive të Përzgjedhura.

2. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, nxit Entin Zbatues të Projektit që:

a) gjatë gjithë kohës së zbatimit të Projektit të mbajë stafin e tij kryesor që ka në përbërje një menaxher të Projektit, një arkitekt, një inxhinier, një specialist për administrimin financiar, një specialist prokurimi, një specialist për angazhimin qytetar, një specialist mjedisi dhe një specialist për problemet sociale, të gjithë këta me kualifikime, përvojë, përgjegjësi dhe iniciativë të pranueshme për Bankën; dhe,

b) të realizojë zbatimin e Projektit, duke përfshirë administrimin financiar, prokurimin dhe menaxhimin e kontratave.

2. Komiteti Drejtues i Projektit

Huamarrësi:



a) jo më vonë se dy muaj pas datës së hyrjes në Fuqi, krijon dhe, në vijim, mban, gjatë gjithë kohës së zbatimit të Projektit, një Komitet Drejtues të Projektit (KDP) që ka në përbërje përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Kulturës, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave, Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, Enti Zbatues i Projektit dhe Bashkitë e Përzgjedhura; dhe,

b) siguron që KDP-ja: (i) të mblidhet të paktën çdo gjashtë (6) muaj; (ii) të mbështesë Ministrinë e Zhvillimit Urban për të mbikëqyrur në mënyrë tërësore menaxhimin e Projektit, përfshirë, mes të tjerash, duke mbështetur bashkërendimin e palëve të interesuara dhe duke zgjidhur çështje ose probleme të rëndësishme ndërrajonale apo bllokimit që shkaktohen gjatë zbatimit të Projektit.

#### B. Masat për zbatim

##### 1. Manuali Operacional i Projektit

a) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, nxit Entin Zbatues të Projektit që të përgatisë dhe miratojë një Manual Operacional të Projektit në formë dhe me përmbajtje të pranueshme për Bankën, dhe në vijim ta zbatojë Projektin në përputhje me Manualin Operacional të Projektit.

b) Përveç kur Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, dhe Banka mund të bien dakord ndryshe me shkrim, Huamarrësi nuk lejon që Enti Zbatues i Projektit ta shfuqizojë, amendojë, pezullojë, heqë dorë nga apo eventualisht, të mos e zbatojë Manualin Operacional të Projektit apo ndonjë dispozitë të tij.

c) Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të Manualit Operacional të Projektit dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozita e kësaj Marrëveshjeje do të ketë përparësi.

##### 2. Marrëveshja e kanalizimit

a) Për mundësimin e zbatimit të Projektit, Huamarrësi i vë të ardhurat nga huaja në dispozicion, mbi bazë granti, të Entit Zbatues të Projektit sipas një marrëveshjeje kanalizimi (Marrëveshja e Kanalizimit) që lidhet ndërmjet Huamarrësit dhe Entit Zbatues të Projektit sipas kushteve dhe afateve që miraton Banka.

b) Huamarrësi i ushtron të drejtat e tij dhe i zbaton detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Kanalizimit, në mënyrë që të mbrojë interesat e

Huamarrësit dhe të Bankës dhe të arrijë qëllimet e Huas. Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, Huamarrësi nuk e transferon, amendon, shfuqizon apo nuk heq dorë nga Marrëveshja e Kanalizimit apo ndonjë prej dispozitave të saj.

#### C. Antikorrupsioni

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, garanton që Projekti të zbatohet në përputhje me dispozitat e udhëzuesit për antikorrupsionin.

#### D. Masat mbrojtëse

1. Për të garantuar zbatimin siç duhet të Projektit, në mënyrë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore dhe sociale, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, nxit Entin Zbatues të Projektit që:

a) ta zbatojë Projektin në përputhje me instrumentet e masave mbrojtëse për Projektin;

b) para kryerjes së ndonjë punimi sipas Projektit: (i) të përgatisë PMMS-të për zonën e caktuar turistike në përputhje me KMMS-në përkatëse, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese dhe konsultimin me publikun, në formë dhe me përmbajtje të pranueshme për Bankën; dhe (ii) veprimtaritë në kuadër të Projektit t'i zbatojë në përputhje me PMMS-të përkatëse, përfshirë PMMS-në për rrugën e shtruar me kalldrëm të Beratit dhe PMMS-në për shkallët e Sarandës;

c) para kryerjes së ndonjë punimi sipas Projektit që kërkon risistemim të pavullnetshëm, të përgatisë një PLS për zonën e caktuar turistike në përputhje me KPR-në, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese dhe konsultime serioze me personat e prekur nga Projekti, në formë dhe me përmbajtje të kënaqshme për Bankën, dhe të garantojë që një PLS i tillë të zbatohet, përfshirë dhënien personave të prekur nga Projekti të një kompensimi të drejtë, në përputhje me dispozitat e KPR-së dhe PLS-së për zonën e caktuar turistike dhe,

d) të mos kryejë transferimin, amendimin dhe shfuqizimin ose të mos heqë dorë nga instrumentet e masave mbrojtëse apo nga ndonjë dispozitë e tyre, pa miratimin paraprak të Bankës.

2. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të ndonjë instrumenti të masave mbrojtëse dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.



3. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, nxit Entin Zbatues të Projektit të sigurojë që termat e referencës për çfarëdo konsulence lidhur me Projektin të jenë të pranueshme për Bankën pas shqyrtimit të tyre nga ana e saj, dhe, për këtë qëllim, në këto terma reference përfshihen rregullisht kërkesat e politikave të Bankës në lidhje me masat mbrojtëse në fuqi në atë kohë, siç zbatohet për këshillat që jepen përmes një asistence teknike të tillë.

#### E. Plani vjetor i punës dhe buxheti

1. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, nxit Entin Zbatues të Projektit të përgatisë dhe t'i paraqesë Bankës për shqyrtim dhe miratim, jo më vonë se gjashtëdhjetë ditë pas ditës së hyrjes në fuqi, dhe në vijim, deri në datën 31 tetor të çdo viti financiar, gjatë zbatimit të Projektit, një propozim për planin vjetor të punës dhe buxhetin që mbulojnë gjithë veprimtaritë, të cilat propozohen të kryhen në bazë të Projektit në vitin financiar të ardhshëm.

2. Në çdo plan vjetor pune dhe buxhet të tillë të propozuar, ndër veprimtaritë, përcaktohet qartë çdo veprimtari trajnuese që mund të kërkohet në bazë të Projektit, duke përfshirë: (a) llojin e trajnimit; (b) qëllimin e trajnimit; (c) personelin që duhet trajnuar; (d) institucionin apo individin që do ta zhvillojë trajnimin; (e) vendin dhe kohëzgjatjen e trajnimit; (f) koston e trajnimit; dhe (g) rezultatin dhe ndikimin e pritshëm të trajnimit.

3. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, i siguron Bankës një mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer pikëpamje me Huamarrësin, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, lidhur me çdo plan vjetor pune dhe buxhet të tillë të propozuar, dhe në vijim, zbaton Projektin ose nxit Entin Zbatues të Projektit ta zbatojë me kujdesin e duhur, në përputhje me një plan vjetor pune dhe buxhet të tillë që miratohet nga Banka.

Seksioni II. Monitorimi dhe vlerësimi i Projektit dhe raportimi në lidhje me të

#### A. Raportet për Projektin

1. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, nxit Entin Zbatues të Projektit që të monitorojë dhe vlerësojë ecurinë e Projektit, dhe të përgatisë raportet për Projektin në përputhje me dispozitat e seksionit 5.08 të kushteve të përgjithshme dhe në bazë të treguesve të pranueshëm për Bankën.

2. Çdo raport për Projektin përmbledh periudhën e një semestri kalendarik dhe i dorëzohet Bankës jo më vonë se një muaj pas mbarimit të periudhës që përmbledh ky raport.

B. Administrimi financiar, raportet financiare dhe auditimet

1. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, mban ose nxit Entin Zbatues të Projektit që të mbajë një sistem për administrimin financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, nxit Entin Zbatues të Projektit që të përgatisë, dhe t'i dorëzojë Bankës jo më vonë se 45 ditë pas mbarimit të çdo tremujori kalendarik, raporte të ndërmjetme financiare të paaudituar për Projektin që përmbledhin tremujorin, në formë dhe me përmbajtje të pranueshme për Bankën.

3. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, nxit Entin Zbatues të Projektit që të sigurojë auditimin e pasqyrave financiare lidhur me Projektin në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Çdo auditim i pasqyrave financiare përmbledh periudhën e një viti financiar të Huamarrësit, duke filluar nga viti financiar në të cilin është kryer tërheqja e parë për Projektin. Pasqyrat financiare të audituara për çdo periudhë të tillë i dorëzohen Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas mbarimit të një periudhe të tillë.

#### Seksioni III. Prokurimi

##### A. Të përgjithshme

1. Mallra, punime dhe shërbime jokonsulence. Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulence që kërkohen për Projektin dhe që duhen financuar me të ardhurat nga huaja, prokurohen në përputhje me kërkesat që parashikohen apo përmenden në seksionin I të udhëzuesit për prokurimin, si dhe me dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulencës. Të gjitha shërbimet e konsulencës që kërkohen për Projektin dhe që duhen financuar me të ardhurat nga huaja, prokurohen në përputhje me kërkesat që parashikohen apo përmenden në seksionet I dhe IV të udhëzuesit për konsulentët, si dhe me dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizime. Termat e shkruar me germa kapitale që përdoren më poshtë në këtë seksion për të dhënë një përshkrim të metodave të posaçme të



prokurimit apo metodave të Bankës për shqyrtimin e marrëveshjeve të posaçme, i referohen metodës përkatëse, një përshkrim i të cilës jepet në seksionet II dhe III të Udhëzuesit për Prokurimin apo në seksionet II, III, IV dhe V të Udhëzuesit për Konsulentët, sipas rastit.

B. Metodatat e Posaçme të Prokurimit të Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve Jokonsulente

1. Oferta Ndërkombëtare për Konkurrin. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente prokurohen sipas marrëveshjeve që jepen mbi bazën e Ofertës Ndërkombëtare për Konkurrin.

2. Metoda të tjera për Prokurimin e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve Jokonsulente. Metodatat më poshtë, përveç Ofertës Ndërkombëtare për Konkurrin, mund të përdoren për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente për ato marrëveshje që përcaktohen qartë në Planin e Prokurimit: (a) Oferta Kombëtare për Konkurrin sipas dispozitave shtesë të paragrafit 3 të këtij seksioni; (b) Blerjet, dhe (c) Kontraktimi i Drejtpërdrejtë.

3. Ndryshime të procedurave të Huamarrësit në lidhje me Ofertën Kombëtare për Konkurrin

Procedurat në lidhje me Ofertën Kombëtare për Konkurrin (OKK) bazohen në procedura të hapura tenderimi, siç është përcaktuar në ligjin shqiptar “Për prokurimin publik” (LPP) (ligji nr. 9643, datë 20 nëntor 2006, i ndryshuar), me kusht, sidoqoftë, që një procedurë e tillë t’u nënshtrohet dispozitave të seksionit I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të Udhëzuesit për Prokurimin dhe këtyre dispozitave shtesë:

a) Procedura “të hapura tenderimi”, siç është përcaktuar në LPP-në e Shqipërisë, zbatohen për të gjitha marrëveshjet e financuara nga Banka.

b) Ofertuesit e huaj nuk përjashtohen nga paraqitja e ofertave dhe asnjë preferencë e ndonjë lloji nuk u jepet ofertuesve vendas në procesin e tenderit. Në Shqipëri lejohet që ndërmarrjet shtetërore të paraqesin oferta vetëm në rast se janë të pavarura nga pikëpamja ligjore dhe financiare, dhe vepron në bazë të së drejtës tregtare të Huamarrësit. Regjistrimi nuk përdoret për të vlerësuar kualifikimet e ofertuesve.

c) Ofertat hapen në mënyrë publike, në një vend, menjëherë pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, në prani të

përfaqësuesve që vendosin të marrin pjesë.

d) Entet prokuruese përdorin dokumentet model të tenderit, siç janë miratuar nga Banka.

e) Në rast të çmimeve më të larta të ofertave, krahasuar me vlerësimin zyrtar, asnjë ofertë nuk refuzohet pa miratimin paraprak të Bankës.

f) Për paraqitjen e ofertave përdoret procedura me një zarf të vetëm.

g) Paskualifikimi bëhet vetëm për ofertuesin me vlerësimin më të ulët; asnjë ofertë nuk refuzohet në kohën e hapjes së ofertave për arsye kualifikimi.

h) Ofertuesit në formën e sipërmarrjes së përbashkët mbajnë përgjegjësi në mënyrë të pakufizuar dhe solidare.

i) Para se të refuzohen të gjitha ofertat dhe të kërkohen oferta të reja, merret miratimi paraprak i Bankës.

j) Marrëveshjet i jepen ofertuesit kryesisht të kualifikuar, me vlerësimin më të ulët, i cili është i vendosur të kualifikohet që të veprojë në përputhje me kriteret për vlerësimin, të përcaktuara dhe të publikuara më parë.

k) Nuk lejohet negocimi pas tenderimit me ofertuesin që ka vlerësimin më të ulët apo me ndonjë ofertues tjetër.

l) Marrëveshjet e gjata (mbi 18 muaj) përmbajnë dispozita për rregullimin e çmimit të përshtatshëm, të pranueshme për Bankën.

m) Sigurimet e ofertave dhe marrëveshjeve janë në formatin që përfshihet në dokumentet e tenderit që përmenden në pikën (d) më lart. Sigurimi i ofertës është i vlefshëm deri njëzetetë (28) ditë pas përfundimit të periudhës fillestare të vlefshmërisë së ofertës apo pas përfundimit të çdo periudhe të zgjatur, nëse kërkohet. Asnjë pagesë paradhënieje nuk bëhet pa një sigurim të përshtatshëm të pagesës së paradhënies.

n) Dokumenti i tenderit dhe marrëveshja që çmohen të pranueshme nga Banka, përmbajnë dispozita që paraqesin politikën e Bankës për ndalimin e firmave apo individëve, të përfshirë në vjedhje dhe korrupsion, siç është përcaktuar në Udhëzuesin për Prokurimin.

o) Në përputhje me Udhëzuesin për Prokurimin, çdo dokument tenderi dhe marrëveshje që financohet me të ardhurat nga Huaja, parashikon që ofertuesit, furnitorët dhe kontraktuesit, si dhe nënkontraktuesit, agentët, personeli, konsulentët, sipërmarrësit e shërbimeve apo furnitorët e tyre, lejojnë që Banka të inspektojë



të gjithë llogaritë, dokumentacionin dhe dokumente të tjera në lidhje me paraqitjen e ofertave dhe zbatimin e marrëveshjeve, dhe t'ia nënshtrojë auditimit nga auditues të caktuar nga Banka. Pa u kufizuar në dispozitat e paragrafit 1.16 (a) (v) (bb) të Udhëzuesit për Prokurimin, veprimet që synojnë të pengojnë kryesisht ushtrimin nga ana e Bankës e të drejtave të saj për inspektim dhe auditim sipas Udhëzuesit për Prokurimin, përbëjnë një praktikë penguese, siç është përcaktuar në Udhëzuesin për Prokurimin.

C. Metoda të Posaçme të Prokurimit të Shërbimeve të Konsulencës

1. Përzgjedhja mbi bazën e Cilësisë dhe Kostos. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulencës prokurohen sipas marrëveshjeve që jepen sipas Përzgjedhjes mbi bazën e Cilësisë dhe Kostos.

2. Metoda të tjera të Prokurimit të Shërbimeve të Konsulencës. Metodatat më poshtë, përveç Përzgjedhjes mbi bazën e Cilësisë dhe Kostos, mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulencës për ato marrëveshje që përcaktohen qartë në Planin e Prokurimit: (a) Përzgjedhja mbi bazën e cilësisë; (b) Përzgjedhja sipas një Buxheti Fiks; (c) Përzgjedhja e Kostos më të Ulët; (d) Përzgjedhja mbi bazën e Kualifikimeve të Konsulentëve, (e) Përzgjedhja me burim të vetëm të firmave të konsulencës; (f) Procedurat që parashikohen në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të

Udhëzuesit për Konsulentët në lidhje me Përzgjedhjen e Konsulentëve të Veçantë; dhe (g) Procedurat me burim të vetëm për Përzgjedhjen e Konsulentëve të Veçantë.

D. Shqyrtimi nga Banka i Vendimeve për Prokurimin

Plani i Prokurimit përcakton ato marrëveshje që janë objekt i Shqyrtimit Paraprak nga ana e Bankës. Të gjitha marrëveshjet e tjera janë objekt i Shqyrtimit të Mëpasshëm nga ana e Bankës.

Seksioni IV. Tërheqja e të Ardhurave nga Huaja  
A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund t'i tërheqë të ardhurat nga Huaja në përputhje me dispozitat e nenit II të Kushteve të Përgjithshme, të këtij seksioni, dhe atyre udhëzimeve shtesë që Banka i përcakton qartë me anë të një njoftimi për Huamarrësin (duke përfshirë “Udhëzuesin e Bankës Botërore në lidhje me disbursimet për projektet”, maj 2006, që rishikohet herë pas here nga Banka dhe bëhet i aplikueshëm për këtë Marrëveshje në zbatim të udhëzimeve të tilla) për financimin e Shpenzimeve të Justifikuara, siç përcaktohen në tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela më poshtë përcakton kategoritë e Shpenzimeve të Justifikuara që mund të financohen me fondet e Huas (“Kategoria”), alokimin e shumave të Huas për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që duhen financuar për Shpenzimet e Justifikuara në çdo Kategori.

Kategoria	Shuma e Huas e Alokuar (shprehur në Euro)	Përqindja e shpenzimeve që duhen financuar (duke përfshirë tatimet)
(1) Punime	49,816,500	100%
(2) Mallra	2,530,000	100%
(3) Shërbime konsulence	8,710,000	100%
(4) Kosto Operative	2,530,000	100%
(5) Trajnim	54,000	100%
(6) Tarifa filim-mbarim	159,500	Shuma që paguhet në zbatim të seksionit 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.07 (b) të Kushteve të Përgjithshme
SHUMA TOTALE	63,800,000	

B. Kushtet e Tërheqjes; Periudha e Tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e Pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk bëhet për pagesat që kryhen para datës së kësaj Marrëveshjeje.

2. Data e Mbylljes është 31 korrik 2022.

Seksioni V. Angazhime të tjera/studimet për projekte urbane

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, nxit Entin Zbatues të Projektit të sigurojë që çdo studim për projekte urbane, i ndërmarrë në kuadër të pjesës 1 (a) të Projektit, të jetë i pranueshëm për Bankën.





### SHTOJCA 3 AFATI I SHLYERJES

1. Tabela vijuese përcakton Datat e Pagesës së Principalit të Huas dhe përqindjen e shumës së përgjithshme të principalit të Huas që paguhet çdo Datë të Pagesës së Principalit (Pjesa e Këstit). Në rast se të ardhurat nga Huaja janë tërhequr plotësisht deri në Datën e Pagesës së parë të Principalit, shumën e principalit të Huas që shlyen Huamarrësi çdo Datë të Pagesës së Principalit e vendos Banka duke shumëzuar: (a) Shumën e Tërhequr të Huas deri në Datën e Pagesës së parë të Principalit; me (b) Pjesën e Këstit për çdo Datë të Pagesës së Principalit.

Data e Pagesës së Principalit	Pjesa e Këstit (shprehur në përqindje)
Çdo datë 1 prill dhe 1 tetor Duke filluar nga data 1 prill 2025 deri në datën 1 prill 2041	2.94%
Më 1 tetor 2041	2.98%

2. Në rast se të ardhurat nga Huaja nuk janë tërhequr plotësisht deri në Datën e Pagesës së parë të Principalit, shuma e principalit të Huas që shlyen Huamarrësi çdo Datë të Pagesës së Principalit caktohet si vijon:

a) Në masën që çfarëdo e ardhure nga Huaja është tërhequr deri në Datën e Pagesës së parë të Principalit, Huamarrësi e shlyen Shumën e Tërhequr të Huas deri në atë datë, në përputhje me paragrafin 1 të kësaj Shtojce.

b) Çfarëdo shume që tërhiqet pas Datës së Pagesës së parë të Principalit shlyhet çdo Datë Pagese të Principalit që bie pas datës së kësaj tërheqjeje në shumën që vendos Banka, duke e shumëzuar shumën e çdo tërheqjeje të tillë me një thyesë, numërori i së cilës është Pjesa fillestare e Këstit që përcaktohet qartë në tabelën në paragrafin 1 të kësaj shtojce për Datën e Pagesës në fjalë të Principalit (“Pjesa Fillestare e Këstit”) dhe emëruesi i të cilës është shuma e të gjitha Pjesëve Fillestare të tjera të Këstit për Datat e Pagesës së Principalit që bien në ose pas asaj date.

3. (a) Shumat e Huas të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë para çfarëdo Date të Pagesës së Principalit, vetëm për qëllime të llogaritjes së shumave të principalit që paguhet çdo Datë Pagese të Principalit, trajtohen si të tërhequra dhe të prapambetura në Datën e Pagesës së dytë të

Principalit pas datës së tërheqjes, dhe shlyhen çdo Datë të Pagesës së Principalit, duke filluar nga Data e Pagesës së dytë të Principalit pas datës së tërheqjes.

b) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi, në rast se në çdo kohë, Banka miraton një sistem faturimi pas datës së mbarimit të afatit, në bazë të të cilit faturat lëshohen në ose pas Datës së Pagesës përkatëse të Principalit, dispozitat e këtij nënparagrafi nuk zbatohen më për ndonjë tërheqje që bëhet pas miratimit të një sistemi të tillë faturimi.

### ANEKSI SEKSIONI I. PËRKUFIZIME

1. “Program Vjetor i Punës dhe Buxheti” do të thotë plani vjetor i punës dhe buxheti siç përmenden në seksionin I. E të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2. “Udhëzuesi për Antikorrupsionin” do të thotë “Udhëzues për të parandaluar dhe luftuar vjedhjen dhe korrupsionin në projekte të financuara me Hua nga BNRZH dhe Hua e grante nga SHZHN (Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar)”, e datës 15 tetor 2006, e rishikuar në janar 2011.

3. “Politikat e Bankës për Masat Mbrojtëse” do të thotë politikat dhe procedurat operative të Bankës që përcaktohen në manualin operacional të Bankës dhe identifikohen si OP/BP 4.01, 4.04, 4.09, 4.10, 4.11, 4.12, 4.36, 4.37, 7.50 dhe 7.60, manual ky që gjendet i botuar në adresën: [www.WorldBank.org/opmanual](http://www.WorldBank.org/opmanual).

4. “Kategori” do të thotë një kategori që përcaktohet në tabelën e seksionit IV të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

5. “Udhëzues për Konsulentët” do të thotë “Udhëzues: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve në kuadër të Huave të BNRZH-së dhe Huave e grandeve të SHNZH-së nga huamarrësit e Bankës Botërore”, janar 2011 (rishikuar në korrik 2014).

6. “Marrëveshje bashkëpunimi” do të thotë një marrëveshje që lidhet ndërmjet Entit Zbatues të Projektit dhe një Bashkie të Përzgjedhur, një Ministrie apo Agjencie Shtetërore dhe që përmendet në seksionin 1.B.2 të Shtojcës të Marrëveshjes për Projektin.



7. “Partneritetet për Menaxhimin në Destinacion” do të thotë njësitë brenda Drejtorive të Turizmit dhe Kulturës të Bashkive të Përzgjedhura, përgjegjëse për zhvillimin dhe marketingun e produkteve turistike.

8. “Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj” do të thotë njësi në zyrën e Kryeministrit që është ngritur dhe vepron në bazë të urdhrat të Kryeministrit nr. 204, datë 1 nëntor 2013 apo pasardhësit të tij.

9. “Kuari për Menaxhimin Mjedisor dhe Social” apo “KMMS” do të thotë kuadri i Projektit që ka përgatitur Enti Zbatues i Projektit dhe është publikuar në Infoshop të Bankës në datën 21 qershor 2016 dhe në grupin e faqeve të internetit të Entit Zbatues të Projektit në datën 22 qershor 2016 që, mes të tjerash, përcakton modalitetet për vlerësimin mjedisor dhe social të zonës së caktuar turistike, duke përfshirë: (a) udhëzuesin për identifikimin e kushteve ekzistuese mjedisore dhe sociale dhe të ndikimeve e risqeve të mundshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore dhe sociale si rezultat i zbatimit të Projektit; (b) udhëzuesin për kryerjen e vlerësimeve mjedisore dhe sociale dhe përgatitjen e planeve për menaxhimin mjedisor, sipas rastit; (c) rekomandimin e masave zbutëse për çdo ndikim negativ që identifikohet; (d) masat për nxitjen e çdo ndikimi pozitiv që identifikohet; dhe (e) udhëzuesin për përgatitjen e planeve për monitorimin mjedisor dhe social për të ndjekur nga afër zbatimin e masave zbutëse, kuadër ky që mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

10. “Plani (Planet) për Menaxhimin Mjedisor dhe Social” apo “PMMS”-të do të thotë Plane për Menaxhimin Mjedisor dhe Social për zonën e caktuar turistike, të pranueshme për Bankën, që përfshijnë planin për zbutjen e ndikimeve ndaj mjedisit dhe planin për monitorimin mjedisor që duhet të përgatisë dhe miratojë Enti Zbatues i Projektit në zbatim të PMMS-së, ku parashikohen hollësi të veçanta të masave për menaxhimin e risqeve të mundshme apo të identifikuar mjedisore dhe sociale dhe për zbutjen, reduktimin dhe/ose kompensimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale negative si pasojë e zbatimit të veprimtarive në kuadër të Projektit, krahas një standardi mjedisor dhe social për çdo zonë turistike, hollësive të kuadrit legjislativ përkatës për mjedisin, masave të përshtatshme institucionale dhe masave të

përshtatshme për monitorimin dhe raportimin, të afta për sigurimin e zbatimit siç duhet të afateve të tij dhe dhënien rregullisht të opinionit përsa i takon respektimit të tyre, plane këto që mund të ndryshohen dhe plotësohen herë pas here me miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

11. “PMMS për Rrugën e Shtruar me Kalldrëm të Beratit” dhe “PMMS për Shkallët e Sarandës”, secili, do të thotë planet për menaxhimin mjedisor dhe social që kanë përgatitur dhe miratuar Huamarrësi dhe Enti Zbatues i Projektit, përkatësisht, për zonat turistike të Beratit dhe Sarandës dhe janë të pranueshëm për Bankën, dhe që janë publikuar në Infoshop në datën 18 korrik 2016.

12. “Kushtet e Përgjithshme” do të thotë “Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërko-mbëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Huat”, datë 12 mars 2012, me ndryshimet që parashikohen në seksionin II të këtij aneksi.

13. “Kosto Operative” do të thotë shpenzimet shtesë të kryera nga Enti Zbatues i Projektit dhe NJKP-ja për llogari të zbatimit të Projektit, ku nuk mungojnë menaxhimi dhe monitorimi i Projektit, dhe që përfshijnë shpenzimet për qiranë e zyrës, funksionimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, pajisjet dhe materialet e zyrës, shpenzimet për komunikimin, mbështetjen për sistemin e informacionit, përkthimet, taksat bankare, shpenzimet për udhëtim dhe dieta, pagat e stafit të kontraktuar të Entit Zbatues të Projektit (duke përfshirë shërbimet e konsulencës dhe pagat e punonjësve të shërbimit civil të Përfituesit), Kontributet Shoqërore për stafin e Entit Zbatues të Projektit, shpenzimet administrative për zyrën dhe shpenzime të tjera të arsyeshme që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e Projektit, siç bie dakord Banka; dhe mbi bazën e një buxheti vjetor të pranueshëm për Bankën.

14. “Risistemim i pavullnetshëm” do të thotë ndikimi nga marrja e pavullnetshme e tokës në kuadër të Projektit, marrja e të cilës bën që Personave të Prekur nga Projekti, ndër të tjera: (a) t’u cenohet negativisht niveli i jetesës; apo (b) t’u cenohet e drejta, titulli apo interesi në një shtëpi, tokë (duke përfshirë ndërtesat, tokën bujqësore dhe kullotë) apo ndonjë pasuri tjetër e tundshme apo e patundshme e trashëguar ose në zotërim, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme; apo (c) t’u cenohet negativisht, në mënyrë të përkohshme



ose të përhershme, mundësia për përdorimin e asetëve produktive; apo (d) t'u cenohen negativisht, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, veprimtaria tregtare, puna dhe vendi i punës, i qëndrimit apo i banimit.

15. "MZHETTS" do të thotë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes e Huamarrësit apo pasardhësit të tij.

16. "MK" do të thotë Ministria e Kulturës e Huamarrësit apo pasardhësit të tij.

17. "MM" do të thotë Ministria e Mjedisit e Huamarrësit apo pasardhësit të tij.

18. "MF" do të thotë Ministria e Financave e Huamarrësit apo pasardhësit të tij.

19. "MZHU" do të thotë Ministria e Zhvillimit Urban e Huamarrësit apo pasardhësit të tij.

20. "Agjencitë Shtetërore Qendrore Pjesëmarrëse" do të thotë Ministria e Mjedisit, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

21. "Personat e Prekur nga Projekti" do të thotë persona, të cilët, për shkak të zbatimit të Projektit, janë prekur ose do të preken nga Risistemimi i Pavullnetshëm.

22. "Marrëveshja për Projektin" do të thotë marrëveshja që duhet të lidhin Banka dhe Enti Zbatues i Projektit, dhe që përmendet në seksionin 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshje kjo që mund të ndryshohet herë pas here, dhe një kusht i tillë vlen për të gjitha shtojcat dhe marrëveshjet shtesë të Marrëveshjes për Projektin.

23. "Njësia për Koordinimin e Projektit" apo NJKP do të thotë njësia që ngrihet në MZHU dhe përmendet në seksionin I.A.1 të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

24. "Enti Zbatues i Projektit" do të thotë Fondi Shqiptar i Zhvillimit ose FSHZH, fondacion jofitimprurës me pavarësi administrative, financiare dhe teknike.

25. "Legjislacioni për Entin Zbatues të Projektit" do të thotë Ligji nr. 10130, datë 11.05.2009 dhe Ligji i Huamarrësit nr. 82, datë 17.07.2009.

26. "Udhëzuesi për Prokurimin" do të thotë "Udhëzues: prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente në kuadër të Huave të BNRZH-së dhe Huave e grandeve të SHNZH-së nga huamarrësit e Bankës Botërore", janar 2011 (rishikuar në korrik 2014).

27. "Manuali Operacional i Projektit" do të thotë manuali që duhet të përgatitet dhe miratojë Enti Zbatues i Projektit dhe të jetë i pranueshëm për Bankën, duke përfshirë një përshkrim të hollësishëm të Projektit, procedurat për zbatimin e Projektit, masat e hollësishme institucionale, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe me ligjet dhe rregulloret në fuqi, dhe duke përfshirë, mes të tjerash, grafikët e veprimeve që kërkohet të kryhen në kuadër të Projektit, plotësimin me personel, aspektet e besimit, teknike dhe operative dhe procedurat për zbatimin e Projektit, përfshirë procedurat e administrimit financiar (buxhetimi, kontabiliteti dhe kontrolli i brendshëm, disbursimi dhe kalimi i fondeve, raportimi financiar, raportet vjetore, procedurat për planifikimin e auditimeve të brendshme dhe të jashtme, si dhe përfshirë planin e posaçëm kontabël të Projektit), Marrëveshjen model të Bashkëpunimit, procedurat e prokurimit, KMMS-në dhe KPR-në, masat për monitorimin dhe vlerësimin, dhe masat e tjera të besimit dhe administrative, manual ky që mund të ndryshohet herë pas here me miratimin e Bankës.

28. "Plani i Prokurimeve" do të thotë plani i Huamarrësit për prokurimet për Projektin, i datës 15 korrik 2016 dhe që përmendet në paragrafin 1.18 të Udhëzuesit për Prokurimin dhe në paragrafin 1.25 të Udhëzuesit për Konsulentët, plan ky që përditësohet herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafëve në fjalë.

29. "Plani i Veprimit për Risistemimin" ose "PVR" do të thotë një plan, i pranueshëm për Bankën që duhet të përgatitet dhe zbatohet Enti Zbatues i Projektit për kryerjen e veprimtarive në kuadër të Projektit në përputhje me Kuadrin e Politikave për Risistemimin, dhe për parashtrimin, mes të tjerash, të parimeve dhe objektivave, përbushjes së kritereve nga personat e prekur, të drejtat për kompensim, asistencë dhe rehabilitim, si dhe të procedurave të monitorimit dhe raportimit në përputhje me Kuadrin e Politikave për Risistemimin, plan ky që mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

30. "Kuadri i Politikave për Risistemimin" ose "KPR" do të thotë dokumenti i përgatitur nga Enti Zbatues i Projektit dhe i publikuar në grupin e faqeve të internetit të Entit Zbatues të Projektit në datën 21 qershor 2016 dhe në Infoshop të Bankës më datë 22 qershor 2016, i pranueshëm për



Bankën, ku përcaktohen modalitetet për blerjen e tokës në kuadër të Projektit dhe jepet një përshkrim i politikave, procedurave, planeve dhe veprimeve (duke përfshirë përgatitjen e planeve të veprimit për risistemimin) dhe i masave institucionale në lidhje me blerjen e tokës dhe i ndikimeve të tjera sociale që mund të ndodhin gjatë Projektit, kuadër ky që mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

31. “Instrument i Masave Mbrojtëse” do të thotë KMMS, PMMS, KPR ose një PLS për një veprimtari të Projektit, siç mund ta kërkojë konteksti; dhe “Instrumente të Masave Mbrojtëse”, bashkërisht, do të thotë të gjitha këto vlerësime ose plane për Projektin.

32. “Zonat e Përzgjedhura” do të thotë Bashkitë e Përzgjedhura dhe Korridori Turistik (siç referohet më poshtë), dhe ndër to përfshihet çdo bashki dhe zonë tjetër turistike, siç mund të bjerë dakord Banka.

33. “Bashkitë e Përzgjedhura” do të thotë bashkitë vijuese të Huamarrësit, specifikisht Saranda, Gjirokastra, Berati dhe Përmeti.

34. “Kontribute Shoqërore” do të thotë çdo pagesë, prim apo kontribut për sigurimin shëndetësor dhe shoqëror që u sigurohet punonjësve të Entit Zbatues të Projektit në zbatim të ligjit nr. 7703 të datës 11 maj 1993, të Huamarrësit, të ndryshuar.

35. “Marrëveshje Kanalizimi” do të thotë marrëveshja që përmendet në seksionin I.B.2 të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje, në zbatim të së cilës Huamarrësi i vë të ardhurat nga Huaja në dispozicion të Entit Zbatues të Projektit.

36. “Drejtoria e Turizmit dhe Kulturës” do të thotë një drejtori në një Bashki të Përzgjedhur përgjegjëse për turizmin dhe kulturën.

37. “Korridor Turistik” do të thotë rruga e transportit që lidh qytetin e Vlorës me Bashkitë e Përzgjedhura.

38. “Trajnim” do të thotë shpenzimet (përveç atyre për shërbimet e konsulencës), që kryen Enti Zbatues i Projektit në lidhje me zbatimin e Projektit, mbi bazën e buxheteve periodike të pranueshme për Bankën, për: (i) shpenzime të arsyeshme për udhëtim, fjetje, ushqim dhe dieta që bëjnë trajnuesit dhe të trajnuarit në lidhje me trajnimin e tyre; (ii) tarifën e kurseve; (iii) marrjen me qira të mjediseve dhe pajisjeve për trajnim /seminare me veprimtari praktike; dhe (iv)

shpenzimet për përgatitjen, blerjen, riprodhimin dhe shpërndarjen e materialeve të trajnimit që nuk janë të përfshira në marrëveshjet për mallrat apo të sipërmarrësve të shërbimeve.

## SEKSIONI II NDRYSHIMET E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME

Me anë të kësaj Kushtet e Përgjithshme ndryshojnë si vijon:

1. Te Tabela e Lëndës, referimet ndaj seksioneve, titujve të seksioneve dhe numrave të seksioneve janë ndryshuar, me qëllim që të pasqyrojnë ndryshimet që parashtrihen në paragrafët më poshtë.

2. Seksioni 3.01 (*Tarifa fillestare*) është ndryshuar dhe interpretohet si më poshtë:

“Seksioni 3.01 *Tarifa Fillestare; Tarifa e Angazhimit*

a) Huamarrësi i paguan Bankës një tarifë fillestare për shumën e Huas me normën që caktohet në Marrëveshjen e Huas (Tarifa Fillim - mbarim).

b) Huamarrësi i paguan Bankës një tarifë angazhimi për Shumën e Patërhequr të Huas me normën që caktohet në Marrëveshjen e Huas (Tarifa e Angazhimit). Tarifa e Angazhimit përlllogaritet nga një datë gjashtëdhjetë ditë pas datës së Marrëveshjes së Huas deri në datat përkatëse kur shumat tërhiqen nga Huamarrësi nga Llogaria e Huas ose anulohen. Tarifa e Angazhimit paguhet çdo gjashtëmujor si detyrim i prapambetur në çdo Datë Pagese.”

3. Tek aneksi, Përkufizimet, të gjithë referimet përkatëse ndaj numrave dhe paragrafëve të seksioneve janë ndryshuar, sipas rastit, për të pasqyruar ndryshimin e parashikuar tek paragrafi 2 më lart.

4. Aneksi është ndryshuar duke vendosur një paragraf të ri 19 me përkufizimin vijues të “Tarifës së Angazhimit”, dhe duke rivendosur numrat vijues sipas rastit:

“19. “Tarifë e Angazhimit” do të thotë tarifa e angazhimit që përcaktohet qartë në Marrëveshjen e Huas për qëllimin e seksionit 3.01(b).”



**LIGJ**  
**Nr. 20/2017**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË  
HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA  
MINISTRIA E FINANCAVE,  
“HUAMARRËSI”, DHE KfW FRANKFURT  
AM MAIN, “KfW”, PËR PROGRAMIN E  
MENAXHIMIT TË MBETJEVE TË  
NGURTA, RAJONI VLORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, “Huamarrësi”, dhe KfW Frankfurt am Main, “KfW”, për financimin e programit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, rajoni Vlorë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.2.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10062, datë 6.3.2017,  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE HUAJE**  
**E DATËS NDËRMJET**

KfW-së, FRANKFURT AM MAIN (“KfW”) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË (“HUAMARRËSI”) 12,000,000.00 EURO PËR PROGRAMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA (RAJONI VLORE) BMZ-NR. 2013 664 59 HUA NR. 27945

**HYRJE**

Baza për këtë marrëveshje huaje ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit (Marrëveshja apo Marrëveshja e Huas) është marrëveshja e datës \_\_\_\_\_ ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Financiar (BF) (Marrëveshje Qeveritare).

KfW-ja do të rifinancojë Huan e dhënë në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, me subvencionet e interesit nga fondet e buxhetit me interes të ulët të garantuara nga Republika Federale e Gjermanisë për projekte që përmbushin kriteret e përshtatshmërisë së zhvillimit të politikave. Termat dhe kushtet e Huas përpunohen me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje për njohjen si Asistencë Zyrtare për Zhvillim (ODA).

Kjo Marrëveshje Huaje “Programi i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta “ dhe granti për “Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, Kësti II” janë burime financimi për investimet e parashikuara që do të zbatohen si një program. Programi do të zbatohet me anë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, Marrëveshjes së Financimit të datës \_\_\_\_\_ (Marrëveshja e financimit për masat shoqëruese) dhe Marrëveshjes së Financimit të datës \_\_\_\_\_ (Marrëveshja e Financimit të Investimit).

Mbi këtë bazë dhe me kusht që Republika Federale e Gjermanisë të japë një garanci për Huan, KfW-ja do të japë një kredi në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje.

**1. Huaja**

**1.1 Shuma.** KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një Hua deri në:

12,000,000.00 EURO (Huaja).

**1.2 Qëllimi.** Huadhënësi do të përdorë Huan vetëm për të financuar Programin e Menaxhimit të



Mbetjeve të Ngurta (Programi) me anë të kanalizimit të Huas së plotë në Bashkinë e Vlorës (“Agjencia e Zbatimit të Projektit” apo AZP) në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, (Njësia e Koordinimit të Programit ose NJKP) në kuadër të Programit do të shfrytëzojë apo garantojë që Agjencia e Zbatimit të Projektit të përdorë fondet e Huas vetëm për financimin e (i) investimeve për përmirësimin e sistemit të heqjes së mbetjeve, (ii) shpërndarjen e pajisjeve për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, (iii) sigurimin dhe rehabilitimin e venddepozitimeve të vjetra, si edhe (iv) shërbimet e një konsulenti zbatimi. NJKP, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë e Programit dhe furnizimet, mallrat, punimet dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja me anë të një marrëveshjeje të veçantë që do të kundërfirmoset nga Përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave (Marrëveshje e Veçantë).

1.3 *Tatimet taksat, detyrimet doganore.* Tatimet dhe taksat e tjera publike për të cilat detyrohet Huamarrësi apo Njësia e Zbatimit të Programit si dhe detyrimet doganore nuk do të financohen nga Huaja.

2. Kanalizimi i Huas në Agjencinë e Zbatimit të Projektit

2.1 *Kanalizimi.* Huamarrësi do të kanalizojë Huan tek Agjencia e Zbatimit të Projektit në bazë të një marrëveshjeje të veçantë nënhuazimi, ku 10% e shumës së kredisë do të kanalizohet si një hua e shlyeshme në pajtim me afatet dhe kushtet e përcaktuara në nenin 5 dhe 6 të kësaj marrëveshjeje, ndërsa 90% do të kanalizohet si grant i pashlyeshëm.

2.2 *Përktimi i Vërtetuar.* Para disbursimit të parë nga Huaja, Huamarrësi do t'i dërgojë KfW-së një përktim të vërtetuar në anglisht ose gjermanisht të Marrëveshjes së Nënhuas të specifikuar në nenin 2.

2.3 *Mungesa e Përgjegjësive të Agjencisë së Zbatimit të Projektit.* Kanalizimi i Huas nuk përbën detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas Marrëveshjes së Huas.

3. Disbursimet

3.1 *Kërkesa për disbursim.* Sapo të përmbushen të gjitha kushtet paraprake për disbursimin në pajtim me nenin 3.3, por jo më parë se data 1 janar 2017, KfW-ja disburson huan në pajtim me progresin e Programit me kërkesë të huamarrësit nëpërmjet

NJKP-së. Disbursimi realizohet në pajtim me programin e disbursimit që gjendet në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje Huaje. KfW-ja kryen disbursime vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo gjashtë mujor. Në masën që Huamarrësi kërkon disbursimin e shumave të vogla brenda një gjysmë viti, shumat e padisbursuara mund të kërkojnë në çdo periudhë pasuese gjashtëmujore.

3.2 *Afati për kërkimin e disbursimit.* KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës 30 dhjetor 2021 apo në një datë tjetër për të cilën të dyja palët bien dakord.

3.3 *Kushtet paraprake për disbursimin.* KfW-ja është e detyruar të kryejë disbursime sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje vetëm pas datës 1 janar 2017 dhe vetëm me përmbushjen e kushteve të mëposhtme paraprake në formën dhe përmbajtjen e pranueshme për KfW-në:

a) Huamarrësi ka demonstruar, në mënyrë të kënaqshme për KfW-në, duke paraqitur një opinion ligjor me përmbajtje sipas parashikimit në aneksin 2 dhe duke paraqitur kopje të vërtetuara (secila me një përktim në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje) të të gjitha dokumenteve të cilave u referohet Opinioni Ligjor që Marrëveshja e Huas është ligjërish në fuqi dhe e zbatueshme dhe, në veçanti që

i) Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas ligjit të vet kushtetues dhe dispozitave të tjera ligjore për marrjen përsipër në mënyrë të vlefshme të të gjithë detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje; dhe

ii) KfW-ja përjashtohet nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga interesat, detyrimet, tarifat dhe kostot e ngjashme në Shqipëri kur jep Huan;

b) Palët kanë një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje dhe të Marrëveshjes së Veçantë, secila e nënshkruar ligjërish;

c) modelet e nënshkrimeve të përmendura në nenin 13.1 janë marrë nga KfW-ja;

d) Garancia nga Republika Federale Gjermane e përmendur në nenin 8 është në fuqi pa kufizim;

e) Huamarrësi ka paguar tarifën e menaxhimit të përmendur në nenin 4.2;

f) nuk ka ndodhur ose nuk rrezikon të ndodhë asnjë shkak për zgjidhje marrëveshjeje me anë të një njoftimi, apo përfundimi afati apo vërtetimi apo përmbushjes së një kushti (arsye potenciale për përfundim); dhe



g) nuk kanë lindur rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes së Huas.

Para disbursimit nga Huaja, KfW-ja ka të drejtën për të kërkuar dokumente dhe prova të tjera që çmohen të nevojshme për të vlerësuar përmbushjen e kushteve paraprake të specifikuar në këtë paragraf.

3.4 *Detaje të Procedurës së Disbursimit.* NJKP, Njësia e Zbatimit të Projektit dhe KfW do të përcaktojnë detaje të procedurës së disbursimit, në një Marrëveshje të Veçantë që duhet të kundërfirmoset nga Huamarrësi, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, duke përfshirë kushtet specifike paraprake për disbursimin dhe veçanërisht provat që duhet të paraqiten nga Huamarrësi nëpërmjet NJKP-së që provojnë se shumata e kërkuara të Huas përdoren për qëllimin e parashikuar.

3.5 *Heqja dorë nga disbursimi.* Në pajtim me përmbushjen e detyrimeve të veta sipas nenit 11, Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të Huas me pëlqimin e KfW-së në këmbim të Pagesës së Kompensimit të Mospranimit në pajtim me nenin 3.6.

3.6 *Kompensimi i mospranimit.* Nëse Huamarrësi heq dorë nga disbursimi i një shume të Huas sipas nenit 3.5 më sipër, ose nëse një shumë Huaje nuk disbursohet ose nuk disbursohet në afatin e caktuar në nenin 3.2, Huamarrësi i paguan KfW-së me kërkesën e saj menjëherë atë shumë që është normalisht e nevojshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim, kosto të pësuar nga KfW-ja si rezultat i mosdisbursimit të shumës së Huas në fjalë (Kompensimi i mospranimit), përveçse kur ku mosdisbursim përbën një shkelje të marrëveshjes nga ana e KfW-së. KfW-ja llogarit shumën e Kompensimit të Mospranimit dhe ia komunikon Huamarrësit.

#### 4. Tarifat

4.1 *Tarifa e Zotimit Financiar.* Huamarrësi paguan një tarifë zotimi financiar të pakthyeshme prej 0.25% në vit (Tarifa e Zotimit) për shumata e padisbursuara të Huas.

Tarifa e Zotimit Financiar bëhet e kërkueshme për pagesë çdo gjysmë viti në fund të periudhës më 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti. Së pari, është

e kërkueshme për pagesë më 30 dhjetor 2016 por jo më parë se në datën përkatëse, pas datës në të cilën hyn në fuqi kjo Marrëveshje Huaje në pajtim me nenin 15.10.

Tarifa e zotimit do të përlogaritet, nëse është e zbatueshme me efekt prapaveprues për periudhën që fillon dymbëdhjetë muaj pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë dhe të jetë në fuqi deri në datën e disbursimit të plotë të Huas ose, nëse është e zbatueshme, deri në datën e ndërprerjes përfundimtare të disbursimeve nga Huaja.

4.2 *Tarifa e menaxhimit.* Huamarrësi i paguan KfW-së një shumë të përgjithshme të njëhershme dhe të pakthyeshme si Tarifë Menaxhimi që është e barabartë me 1% të shumës principale të Huas të përcaktuar në nenin 1.1 (Tarifa e Menaxhimit).

Tarifa e Menaxhimit është e pagueshme në rastin më të parë në dy datat e mëposhtme: (i) para disbursimit të parë ose (ii) pas kalimit të një periudhe tremujore pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga KfW apo pas kalimit të një periudhe njëmuajore pasi të ketë hyrë në fuqi kjo Marrëveshje (në varësi të faktit se cila nga datat e parashikuar në pikën (ii) është data më e vonshme). Tarifa e Menaxhimit është e kërkueshme për pagesë sapo kjo Marrëveshje të nënshkruhet, pavarësisht faktit nëse Huaja është disbursuar plotësisht apo pjesërisht apo aspak.

#### 5. Interesi

Huamarrësi do të paguajë interes ndaj KfW-së si vijon:

5.1 *Interesi.* (normë fikse interes që caktohet me angazhimin e Huas). Huamarrësi paguan një interes për Huanë në normën e caktuar nga KfW-ja në një ditë Bankare pasi KfW-ja të ketë marrë njoftim që Marrëveshja ka hyrë në fuqi (data e marrjes nga KfW) (Normë fikse interes) deri sa të jetë marrë shlyerja e kështit të fundit në pajtim me Grafikon e Shlyerjes sipas përcaktimit në nenin 6.1. KfW e njofton Huamarrësin mbi normën e interesit pesë ditë Bankare pas përcaktimit të tij.

5.2 *Llogaritja e interesit.* Interesi për një shumë të disbursuar të Huas do të llogaritet nga data (duke e përjashtuar atë) në të cilën paguhet shumata përkatëse e Huas nga llogaria e Huas që mbahet tek KfW-ja për huamarrësin deri në datën (përfshirë) në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen tek llogaria e KfW-së e përcaktuar në nenin 7.1.

5.3 *Data e pagesës.* Interesi do të bëhet i kërkueshëm për shlyerje në datat e caktuara më poshtë (secila “Datë Pagesë”):



a) para datës së caktuar të kështit të parë të shlyerjes, më 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti, për herë të parë më 30 dhjetor 2016; por jo më herët se në datën e pagesës pas ditës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi në pajtim me nenin 15.10;

b) në datën e caktuar të kështit të parë të shlyerjes në pajtim me nenin 6.1 të këtij neni së bashku me këto këste;

c) më pas në datat e caktuara të kësteve të shlyerjes në pajtim me nenin 6.1.

6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 *Grafiku i shlyerjes*. Huamarrësi do të shlyejë Huan si më poshtë:

Kësti	Data		Shuma	
1	30 dhjetor	2021	571,000.00	euro
2	30 qershor	2022	571,000.00	euro
3	30 dhjetor	2022	571,000.00	euro
4	30 qershor	2023	571,000.00	euro
5	30 dhjetor	2023	571,000.00	euro
6	30 qershor	2024	571,000.00	euro
7	30 dhjetor	2024	571,000.00	euro
8	30 qershor	2025	571,000.00	euro
9	30 dhjetor	2025	571,000.00	euro
10	30 qershor	2026	571,000.00	euro
11	30 dhjetor	2026	571,000.00	euro
12	30 qershor	2027	571,000.00	euro
13	30 dhjetor	2027	572,000.00	euro
14	30 qershor	2028	572,000.00	euro
15	30 dhjetor	2028	572,000.00	euro
16	30 qershor	2029	572,000.00	euro
17	30 dhjetor	2029	572,000.00	euro
18	30 qershor	2030	572,000.00	euro
19	30 dhjetor	2030	572,000.00	euro
20	30 qershor	2031	572,000.00	euro
21	30 dhjetor	2031	572,000.00	euro

6.2 *Shumat e padisbursuara të huas*. Shumat e padisbursuara të Huas do të kompensohen kundrejt shlyerjes së kështit të fundit përkatës të kërkueshëm, në pajtim me grafikun e shlyerjes të përcaktuar në nenin 6.1 përveç kur KfW-ja, në tagrin e saj, zgjedh një kompensim tjetër në raste individuale.

6.3 *Shlyerjet në rastin e disbursimit të papërfunduar*. Nëse një kësht i shlyerjes bëhet i kërkueshëm para se Huaja të jetë disbursuar plotësisht, kjo nuk do të cenojë grafikun e shlyerjes në pajtim me nenin 6.1 për sa kohë që kështi i kërkueshëm i shlyerjes të jetë më i vogël se shuma e disbursuar e Huas dhe që nuk është paguar ende (Shuma e papaguar e Kredisë). Nëse kështi i kërkueshëm i shlyerjes në pajtim me nenin 6.1 e tejkalon Shumën e Papaguar të Kredisë, ky kësht do të ulet në nivelin e Shumës së Papaguar të Kredisë dhe diferenca do të alokohet në mënyrë të barabartë në kështet e shlyerjes që nuk janë paguar ende. Në llogaritjen e Shumës së

papaguar të Kredisë, KfW-ja rezervon të drejtën për të marrë parasysh pagesat nga huaja që janë kryer brenda një periudhe prej 45 ose më pak ditë para Datës së Pagesës për të përcaktuar Shumën e Papaguar të Kredisë vetëm për Datën pasuese të Pagesës.

6.4 *Parapagimi*. Sa më poshtë zbatohet për shlyerjet e parakohshme:

a) *E drejta për të kryer pagesa të parakohshme*. Në pajtim me paragrafët e mëposhtëm (6.4 b) deri në (6.4 e) të këtij neni, Huamarrësi ka të drejtë të shlyejë shumat e Huas para datës së caktuar nëse kjo shlyerje është të paktën sa shuma e një shlyerje kështi në pajtim me nenin 6.1.

b) *Njoftimi*. Një pagesë e parakohshme e shumës së Huas në pajtim me nenin 6.4 a) i nënshtrohet njoftimit të pagesës së parakohshme nga huamarrësi për KfW-në jo më vonë se Dita e pesëmbëdhjetë Bankare (në pajtim me nenin 15.1) në Frankfurt am Main para datës së synuar për





pagesën e parakohshme. Ky njoftim është i parevokueshëm; ai duhet të specifikojë datën në të cilën duhet të kryhet shlyerja e parakohshme dhe shuma e saj dhe e detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e caktuar.

c) *Kompensimi i pagesës së parakohshme.* Nëse Huamarrësi shlyen para kohe një Shumë Huaje që ka një interes me Normë Fikse Interesi, Huamarrësi, brenda 10 Ditëve Bankare, i paguan KfW-së me kërkesë atë shumë që është e nevojshme për të kompensuar një dëm, shpenzim ose kosto të pësuar nga KfW-ja si rezultat i shlyerjes së parakohshme. (Kompensimi i Pagesës së Parakohshme). KfW-ja përcakton shumën e kompensimit të shlyerjes së parakohshme dhe ia komunikon Huamarrësit. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një tregues të shumës së tarifës së parapagimit para njoftimit të parevokueshëm të shlyerjes, në pajtim me nenin 6.4 b).

d) *Shumat e kërkueshme.* Huamarrësi paguan gjithashtu shumat e mëposhtme së bashku me shlyerjen e parakohshme, në pajtim me nenin 6.4:

i) çdo Kompensim të Shlyerjes së parakohshme të kërkueshëm si rezultat i shlyerjes së parakohshme në pajtim me nenin 6.4 c); dhe

iii) të gjithë interesin e mbledhur për shumën e shlyer para kohe të Huas deri në datën e shlyerjes së parakohshme dhe çdo pagese të pashlyer sipas kësaj Marrëveshjeje.

e) *Kompensimi.* Neni 6.2 zbatohet *mutatis mutandis* për kompensimin e shlyerjeve të parakohshme.

6.5 *Grafiku i rishikuar i shlyerjes.* Në rast se zbatohet neni 6.3 (*Disbursimet pas fillimit të shlyerjes*) ose neni 6.4 (*Shlyerja e Parakohshme*), KfW-ja i dërgon Huamarrësit një grafik të rishikuar të shlyerjes që bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje Huaje A dhe e zëvendëson grafikun e shlyerjes të vlefshëm deri në atë datë.

7. Llogaritja dhe pagesat në përgjithësi

7.1 *Llogaritja.* Interesi, Tarifa e Zotimit Financiar, kamatëvonesa në pajtim me nenin 7.5, kompensimi si shumë e plotë për shumat e vonuara në pajtim me nenin 7.6, kompensimi i mospranimit dhe kompensimi i shlyerjes së parakohshme do të llogariten të gjitha mbi bazën e një viti me 360 ditë dhe muaj me 30 ditë.

7.2 *Data e kërkueshme.* Nëse një pagesë që bëhet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje bie në një datë që nuk është Ditë Bankare, Huamarrësi duhet

ta kryejë këtë pagesë në Ditën pasuese Bankare. Nëse Dita pasuese Bankare bie brenda muajit pasues kalendarik, pagesa përkatëse kryhet në Ditën e fundit Bankare të muajit përkatës kalendarik.

7.3 *Numri i llogarisë, koha e kreditimit.* Huamarrësi lirohet nga detyrimet e pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, nëse dhe menjëherë sapo të jenë kredituar shumat përkatëse tek KfW-ja sipas disponimit të lirë pa zbritje në euro dhe jo më vonë se ora 10:00, paradite, në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë në llogarinë e KfW-së në numrin IBAN DE09 5002 0400 3102 5608 01, me referencë shtesë të datës (Ref. YYYYMMDD).

7.4 *Kundërpretendimet e Huamarrësit.* Huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë ndonjë të drejtë për mbajtjen ose kompensimin e të drejtave të krahasueshme kundrejt detyrimeve të pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç kur këto të drejta njihen nga një vendim përfundimtar ose që nuk kundërshtohen nga KfW-ja.

7.5 *Kamatëvonesa.* Nëse shlyerjet e kësteve përkatëse ose shlyerjet e parakohshme në pajtim me nenin 6.4 nuk vihen në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të vendosë kamatëvonesë me një normë prej 200 pikë bazë mbi normën e pandryshueshme të interesit në vit, të përcaktuar në nenin 5.1 për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën në të cilën këto pagesa kreditohen tek llogaria e KfW-së e specifikuar në nenin 7.3. Kjo kamatëvonesë bëhet menjëherë e kërkueshme me kërkesën e parë të KfW-së.

7.6 *Kompensimi me shumë të plotë.* Për shumat e prapambetura (më përjashtim të shlyerjeve të atyre kësteve dhe shlyerjeve të parakohshme që përmenden në nenin 7.5), KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë një kompensim me shumë të plotë me një normë prej 200 pikë bazë në vit mbi Normën vjetore Fikse të Interesit, në pajtim me nenin 5.1 Kompensimi me shumë të plotë bëhet menjëherë i kërkueshëm pas kërkesës së parë të KfW-së. Huamarrësi është i lirë të provojë që realisht nuk është shkaktuar dëm dhe që dëmet nuk janë shkaktuar në shumën e përcaktuar.

7.7 *Kompensimi.* KfW-ja ka të drejtën e kompensimit të pagesave të marra kundrejt pagesave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje



Huaje ose sipas marrëveshjeve të tjera të Huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit. Për shmangien e dyshimit, kjo do të zbatohet në veçanti në situatën e një mospërmbushje detyrimi apo ngjarjeje të mundshme të mospërmbushjes së Huamarrësit.

7.8 *Llogaritjet e kryera nga KfW-ja*. Në mungesë të gabimeve të dukshme, përcaktimet e KfW-së dhe llogaritjet e saj për shumën sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje përbën provë me shikim të parë (*Anscheinsbeweis*).

8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja merr garanci për pretendimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje nga Republika Federale Gjermane para fillimit të disbursimit të parë.

9. Paligjshmëria

Nëse, në çdo juridiksion të zbatueshëm, bëhet e paligjshme për KfW-në për të kryer ndonjë prej detyrimeve të saj të parashikuara nga kjo Marrëveshje ose për të financuar ose mbajtur huanë, pas njoftimit të KfW-së ndaj Huamarrësit:

a) Angazhimi i KfW-së do të anulohet menjëherë, dhe

b) Huamarrësi do të paguajë vetëm shumën e disbursuarë dhe që nuk janë shlyer ende në datën e përcaktuar nga KfW-ja në njoftimin e dërguar për Huamarrësin (jo më parë se ditën e fundit të çdo periudhe lehtësuese të lejuar me ligj).

10. Kostot dhe pagesat publike

10.1 *Ndalimi i zbritjeve dhe ndalesave*. Huamarrësi i kryen të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje pa asnjë zbritje të tatimeve ose detyrimeve të tjera publike apo kostove të tjera. Në rastin kur Huamarrësi është i detyruar me ligj ose për shkaqe të tjera të kryejë këto zbritje apo ndalesa për pagesat, Huamarrësi paguan çdo shumë shtesë të nevojshme për KfW-në, në mënyrë që shumën neto e mbetur pas ndalimit ose zbritjes të përputhet me shumën që do të ishte e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, nëse këto zbritje ose ndalesa nuk do të ishin kryer.

10.2 *Kostot*. Huamarrësi mbulon të gjithë kostot dhe shpenzimet që mblidhen në lidhje me disbursimin apo shlyerjen e Huas, veçanërisht koston e transfertave dhe dërgesave (duke përfshirë tarifën e konvertimit), si dhe të gjithë koston dhe shpenzimet e bëra në lidhje me mbajtjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

10.3 *Taksat dhe detyrimet e tjera*. Huamarrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që paguhen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Nëse KfW jep paradhënie për këto taksa dhe pagesa, Huamarrësi, me kërkesë të KfW-së i transferon ato pa vonesë në llogarinë e përcaktuar në nenin 7.3 apo në një llogari tjetër të përcaktuar nga KfW.

11. Detyrime të veçanta

11.1 *Zbatimi i programit dhe informacioni specifik*. Huamarrësi, nëpërmjet Njesisë së Koordinimit të Programit, merr masa vetë dhe merr gjithashtu masa që Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) të përgatitë, zbatojë, operojë dhe ruajë Programin në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe teknike, kryesisht në pajtim me konceptin e Programit të rënë dakord ndërmjet Njesisë së Koordinimit të Programit, Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) u cakton përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit për Programin inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të pavarur dhe të kualifikuar dhe zbatimin e Programit shoqërive të kualifikuara;

c) jep kontratat për mallrat dhe shërbimet që financohen nga Huaja (neni 11.1 b) me tender konkurrues ndërkombëtar paraprak;

d) siguron financim të plotë të programit dhe i jep KfW-së, me kërkesë, prova që provojnë se kostoja e papaguar nga kjo Hua është e mbuluar;

e) mban libra dhe regjistra që tregojnë qartë koston e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Programin dhe që identifikojnë qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua;

f) merr masa që përfaqësuesit e KfW-së të jenë gjithmonë në gjendje të inspektojnë librat dhe regjistrat dhe të gjithë dokumentacionin përkatës për zbatimin dhe operimin e Programit dhe për të vizituar programin dhe instalimet në lidhje me të;

g) I jep KfW-së çdo informacion të tillë dhe të dhëna të programit dhe progresit të tij të mëtejshëm sipas kërkesës së KfW-së;

h) Menjëherë dhe me pëlqimin e saj:

i) i kalon KfW-së çdo pyetje të marrë nga Agjencia e Zbatimit të Projektit nga OECD-ja ose anëtarët e saj sipas të ashtuquajturës “Marrëveshja për Transparencë të Kredive të Palidhura ODA”, pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen nga Huaja dhe do të bashkërendojë përgjigjen për çdo pyetje të



tillë me KfW-në; dhe

ii) njofton KfW-në për çdo rrethanë që cenon ose rrezikon seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit.

i) nuk hyn në ndonjë transaksion ose nuk angazhohet në aktivitete të tjera në lidhje me Programin që do të përbënte një shkelje të embargos që rregullon tregtinë e jashtme ose të ashtuquajturat sanksione financiare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian apo Republikës Federale të Gjermanisë.

11.2 *Detajet e zbatimit të Programit.* NJKP, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW do të përcaktojnë hollësitë që lidhen me nenin 11.1 të këtij neni me anë të një Marrëveshje të Veçantë, e cila do të kundërfirmoset nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

11.3 *Përputhshmëria.* Huamarrësi siguron që të gjithë personat të cilëve u besojnë përgatitjen dhe zbatimin e Programit, dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen, dhe kërkimin e shumave të Huas, të mos kërkojnë, pranojnë, bëjnë, japin apo garantojnë ndonjë premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

11.4 *Transporti i mallrave.* Dispozitat e parashikuara në Marrëveshjen Qeveritare zbatohen për transportin e mallrave që duhet të financohen nga Huaja.

11.5 *Pastrimi i parave.* Huamarrësi sigurohet që Agjencia e Zbatimit të Projektit i ofron menjëherë KfW-së, me kërkesë, të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të mbushur detyrimet e saj për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të raportit të biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, i cili është i nevojshme për këtë qëllim.

Gjatë lidhjes dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të garantojë që Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emër të saj dhe për llogari të saj. Në lidhje me ligjin gjerman dhe ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit:

a) asnjë prej burimeve ose shumave të Agjencisë së Zbatimit të Projektit të investuara në financimin e Projektit nuk është me origjinë të paligjshme dhe në veçanti, kjo listë nuk është shteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e krimit të organizuar ose terrorizmin;

b) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të angazhohet në marrjen, apo zotërimin ose përdorimin e një prone që është me origjinë të paligjshme;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të lidhet asnjëherë me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e krimit të organizuar, pa qenë kjo listë shteruese;

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të angazhohet në financimin e terrorizmit.

11.6 *Renditja pari passu.* Në masën e lejuar me ligj, Huamarrësi garanton dhe merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje *pari passu* me të gjitha detyrimet e tjera ekzistuese ose të ardhshme të pasiguruara ose të pavarura pagese.

11.7 *Pengu Negativ.* Vetë Huamarrësi nuk do të krijojë ose lejojë, dhe do të garantojë që Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të krijojë ose lejojë që të ketë ndonjë “ Barrë” për sendet pasurore të programit pa pëlqimin paraprak të KfW-së. “Barrë” do të thotë çdo hipotekë, peng, barrë, detyrim apo transferim me anë të garancisë, hipotekës apo interes të garancisë dhe çdo marrëveshje apo angazhim tjetër, efekti i së cilës është krijimi i një garancie apo ndonjë të drejte për dhënie prioriteti shlyerjeje në lidhje me ndonjë detyrim të ndonjë personi.

Ky detyrim nuk zbatohet mbi:

a) barra ekzistuese apo për të cilat është rënë dakord kur kjo Marrëveshje është nënshkruar dhe KfW-ja është njoftuar para nënshkrimit të Marrëveshjes,

b) barrët që janë krijuar në ushtrimin e biznesit sipas rregullave ligjore apo të tjera kontraktuale për të siguruar detyrimet (me përjashtim të detyrimeve të Huas) ndaj furnizuesit apo ofruesve të tjerë të shërbimeve (p.sh. mbajtjen e të drejtave për titullin në industri dhe barrën ligjore),

c) barra që ekzistonin në kohën kur u mor një pasuri, më kusht që këto barra të hiqen tre muaj pas marrjes.

Nëse Huamarrësi i jep siguri palës së tretë ose të drejta të tjera që i mundësojnë palës së tretë të ketë preferenca apo pretendime ndaj ndonjëres prej pasurive pronave apo të ardhurave të Programit të Huamarrësit, KfW-ja mund të japë pëlqimin për Huamarrësin, duke i dhënë KfW-së garancinë (shtesë) në të njëjtën masë që siguron pretendimet e KfW-së ndaj Huamarrësit në pajtim me këtë Marrëveshjeje Huaje.



11.8 *Shitja e sendeve pasurore*. Huamarrësi apo AZP nuk do të shesin ndonjë nga sendet pasurore të Programit deri në momentin që detyrimet e Huamarrësit në këtë Marrëveshje Huaje të jenë shlyer plotësisht.

## 12. Përfundimi i Marrëveshjes

12.1 *Arsyet për përfundim*. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e parashikuara sipas nenit 12.2 (Pasojat ligjore të një Ngjarjeje të Arsyes për Përfundim), nëse ndodh një ngjarje që përbën shkak thelbësor (*wichtiger Grund*). Në veçanti, ngjarjet e mëposhtme përbëjnë shkak material:

a) Huamarrësi nuk përmbush detyrimet ndaj KfW-së për të kryer pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje apo Marrëveshjes së Veçantë, si dhe sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër plotësuese në lidhje me këtë Marrëveshje, janë shkelur;

c) kjo Marrëveshje Huaje ose një pjesë e saj pushon së pasuri efekt detyrues për Huamarrësin ose pushon së qeni e ekzekutueshme ndaj Huamarrësit;

d) çdo deklaratë, konfirmim, informacion ose përfaqësim apo garanci e shqyrtuar nga KfW-ja si thelbësore për dhënien dhe ruajtjen e Huas rezulton e rreme, e gabuar ose e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje;

f) Huamarrësi nëpërmjet NJKP, ose Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk është në gjendje të vërtetojë që shumat e Huas janë përdorur për qëllimin e parashikuar;

g) Huamarrësi nuk është në gjendje të paguajë borxhet kur bëhen të kërkueshme; fillimi i bisedimeve me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit për heqjen dorë nga borxhet e mbetura ose për një moratorium apo zgjidhje apo mosvazhdimin e shërbimit të borxhit.

12.2 *Pasojat ligjore të ngjarjes së arsyes për përfundim*. Nëse një prej rasteve të përmendura në nenin 12.1, ka ndodhur, KfW-ja mund të ndërpresë menjëherë disbursimin sipas kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, nëse ky rast nuk është zgjidhur brenda një periudhe prej pesë Ditësh Bankare (në rastin e nenit 12.1 a) ose, në të gjitha rastet e tjera të specifikuar në nenin 12.1, nuk është zgjidhur brenda një afati të përcaktuar nga KfW-ja që nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, KfW-ja mund të zgjidhë këtë

Marrëveshje Huaje ose pjesë të saj me pasojën që detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje përfundojnë, dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerje të plotë ose të pjesshme të shumës së mbetur të Huas së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje. Neni 7.5 (*Kamatëvonesa*) dhe 7.6 (*Kompensimi me shumë të plotë*) zbatohen për shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

12.3 *Kompensimi për dëmet*. Në rast se kjo Marrëveshje Huaje zgjidhet plotësisht ose pjesërisht para se të jetë bërë shlyerja e plotë, Huamarrësi paguan kompensimin për mospranimin sipas nenit 3.6 (Kompensimi i Mospranimit) dhe/ose Kompensimi i Pagimit të Parakohshëm në pajtim me nenin 6.4 c).

## 13. Përfaqësimet dhe deklaratat

13.1 *Përfaqësimi i Huamarrësit*. Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë huamarrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ministri i Transportit dhe Infrastrukturs dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë huamarrësin në zbatimin e këtij Programi dhe kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon derisa të jetë marrë prej KfW-së anulimi shprehimisht nga përfaqësuesi i Huamarrësit të autorizuar për atë kohë.

13.2 *Adresat*. Njoftimet dhe deklaratimet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje A duhet të jetë me shkrim. Ato duhet të dërgohen në origjinal ose – me përjashtim të kërkesave për disbursim – me faks. Secili dhe të gjithë njoftimet ose deklaratimet e bëra në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje A duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme

Për KfW-në: KfW  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Germany  
Faks: +49 69 7431-2944

Për Huamarrësin: Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3  
Tiranë, Shqipëri  
Faks: +355 4222 8494



14. Publikimi dhe transferimi i informacionit që lidhet me Programin

*Publikimi i informacionit që ka lidhje me Programin nga KfW*

14.1 Në përputhje me parimet e pranuar ndërkombëtarisht të transparencës maksimale dhe efikasitetit në bashkëpunimin për zhvillim, KfW publikon informacionin të përzgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën sesi financohen gjatë bisedimeve para-kontraktuale, ndërsa marrëveshjet e lidhura me shërbimet është\janë duke u zbatuar në një fazë pas kontraktimit (e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet periodikisht në faqen e KfW-së për fushën e saj të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (<http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>)

Publikimi i informacionit (ose nga KfW apo palët e treta në përputhje me nenin 14.3 më poshtë) për Programin dhe mënyrën e tyre të financimit nuk përfshin dokumentacionin kontraktual ose ndonjë informacion sensitiv financiar apo informacion sensitiv biznesi për palët e përfshira në Program apo në financimin e tij, të tilla si:

- a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;
- b) strategji biznesi;
- c) udhëzime dhe raporte të brendshme;
- d) të dhëna personale të personave fizikë;
- e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

14.2 *Transferimi i Informacionit në lidhje me Projektin për Palët e Treta.* KfW-ja ndan informacion të përzgjedhur për Programin dhe mënyrën sesi financohen gjatë të gjithë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, veçanërisht për të siguruar transparencën dhe efikasitetin:

- a) Degët e KfW-së;
- b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë apo subjektet kompetente;
- c) Organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin e zhvillimit dypalësh, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;
- d) organizatat ndërkombëtare të angazhuara në mbledhjen e të dhënave statistikore, dhe anëtarët e tyre veçanërisht Organizata për

Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim në (OECD) dhe anëtarët e saj.

14.3 *Transferimi i informacionit që ka lidhje me Programin tek palët e treta dhe publikimi nga këto palë.* Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacion të përzgjedhur për Programin dhe mënyrës sesi financohen gjatë të gjithë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, të cilat publikojnë artikuj në lidhje me këtë qëllim:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllime të Iniciativës së Transparencës së Ndhmës Ndërkombëtare

[http://www.bmz.de/de/ëas\\_wir\\_machen/wege/transparenz-fuer-mehr\\_Wirksamkeit/index.html](http://www.bmz.de/de/ëas_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr_Wirksamkeit/index.html));

b) Tregu & Investimi Gjerman (GTAI) për qëllime të informacionit të tregut (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD për qëllimin e raportimit të rrjedhës financiare në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllime të vlerësimit të zhvillimit të përgjithshëm të bashkëpunimit Gjerman për të garantuar transparencën dhe eficientë (<http://www.deval.org/de/>).

14.4 *Transferimi i informacionit që ka lidhje me Programin tek palët e treta (duke përfshirë botimin nga to).* KfW-ja, gjithashtu, rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion në lidhje me shërbimet e ekspertëve dhe sesi financohen gjatë Periudhës së Plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e treta, nëse interesat e ligjshme të Përfituesit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshme të Përfituesit në veçanti përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 14.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion për palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregulloreve, ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

15. Dispozita të përgjithshme

15.1 *Ditë Bankare.* Nëse në këtë Marrëveshje Huaje bëhet referencë tek një “Ditë Bankare”, kjo



do të thotë një ditë e ndryshme nga një e shtunë ose e diel, në të cilën bankat tregtare në Frankfurt am Main janë të hapura për biznes të përgjithshëm.

15.2 *Vendi i përmbushjes.* Vendi i përmbushjes së të gjitha detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje është Frankfurt am Main, Republika Federale Gjermane.

15.3 *Pavlefshmëria e pjeshme dhe boshllëqet.* Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje Huaje është ose bëhet e pavlefshme, ose nëse ekziston një boshllëk në një prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Huaje, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e dispozitave të tjera. Palët e kësaj Marrëveshjeje Huaje A e zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë ligjrisht të vlefshme që i afrohet sa më shumë që të jetë e mundur frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët plotësojnë çdo boshllëk në dispozitë me një dispozitë ligjrisht të vlefshme që i afrohet frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje.

15.4 *Forma e shkruar.* Ndryshimet dhe shtesat në këtë kontratë duhet të bëhen me shkrim. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë e formës me shkrim duhet të deklarohet nga palët me shkrim. Ministri i Financave autorizohet të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që cenojnë vetëm marrëdhëniet ligjore midis KfW-së dhe Huamarrësit nuk kërkojnë aprovim nga Agjencia e Zbatimit të Projektit. Ndryshimet në këtë Marrëveshjeje që prekin sasinë apo kushtet financiare të Huas do të kërkojnë ratifikimin nga ana e Kuvendit të Shqipërisë. Të gjitha ndryshimet dhe modifikime të tjera kërkojnë vetëm miratimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Çdo zgjatje e afatit për kërkimin e disbursimeve (neni. 3.2) nuk do të kërkojë miratimin e Këshillit të Ministrave dhe as ratifikimin nga Kuvendi i Shqipërisë.

15.5 *Caktimi.* Huamarrësi nuk mund të caktojë, transferojë, vërë peng apo hipotekë ndaj ndonjë pretendimi nga kjo Marrëveshjeje Huaje.

15.6 *Ligji i zbatuar.* Kjo Marrëveshjeje rregullohet nga ligji gjerman.

15.7 *Afati i parashkrimit.* Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje mbarojnë pesë vjet nga fundi i vitit në të cilin kanë lindur këto të drejta dhe në të cilin KfW-ja është vënë në dijeni të rrethanave që përbëjnë këtë pretendim ose mund të ishte vënë në dijeni pa neglizhencë flagrante.

15.8 *Heqja dorë nga imuniteti.* Në masën që huamarrësi, aktualisht ose në të ardhmen, në një juridiksion mund të pretendojë për vete ose sendet e tij pasurore, imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose një proces tjetër ligjor dhe në masën që në këtë juridiksion mund të merret për vete ose sendet pasurore një imunitet i tillë, Huamarrësi, në mënyrë të pakthyeshme, bie dakord të mos ngrejë pretendim dhe në mënyrë të pakthyeshme heq dorë nga ky imunitet për pretendime nga dhe në lidhje me këtë Marrëveshjeje në masën më të gjerë të lejuar nga ligji i këtij juridiksioni.

Në asnjë rast Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti në lidhje me:

i) mjediset e misionit” të tashme ose të ardhshme sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomate të nënshkruar në 1961, “mjediset konsullore” të tashme ose të ardhshme sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik në Shqipëri ose një agjenci ose instrument i saj;

ii) çdo pasuri e paluajtshme që përfshihet në dispozitat e nenit 3, paragrafët 1–3, të ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001 “Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore”;

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe e paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë sipas traktateve ndërkombëtare të së drejtës publike, konventave dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj.

#### 15.9 *Mosmarrëveshjet ligjore*

##### *Arbitrazhi*

a) Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshjeje huaje zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë aspekt, zbatohen sa më poshtë:

i) Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra që emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) që ndryshohet herë pas here;

ii) Gjykimet në arbitrazh kryhen në Frankfurt am Main. Gjykimet zhvillohen në gjuhën angleze.

15.10 *Hyrja në fuqi.* Kjo Marrëveshjeje Huaje hyn në fuqi jo më parë se:



a) Huamarrësi të ketë informuar KfW-në me shkrim që Marrëveshja e Huas është ratifikuar (data e marrjes në KfW); dhe

b) Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën është bazuar, ka hyrë në fuqi.

Përgatitur në dy kopje origjinale në gjuhën angleze

Tiranë, \_\_\_\_\_

KfW

Nga: Nga:

Emri: Emri:

Titulli: Titulli:

Republika e Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave

Nga:

Emri:

Titulli:

## PROGRAMI I DISBURSIMIT

### ANEKSI 1

Programi i disbursimit

Deri në fund të çdo periudhe disbursimi (Data e Përfundimit të Periudhës në pajtim me listën e mëposhtme), Huamarrësi mund të kërkojë disbursim që nuk kalon në total shumën e disbursimeve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

Periudha	Data e Përfundimit të Periudhës	Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në përfundimin e periudhës (kumulative) (të gjitha shifrat në euro)
1	30.12.2016	0,00
2	30.06.2017	0,00
3	30.12.2017	252,000.00
4	30.06.2018	756,000.00
5	30.12.2018	2,256,000.00
6	30.06.2019	4,260,000.00
7	30.12.2019	6,264,000.00
8	30.06.2020	9,264,000.00
9	30.12.2020	12,000,000.00

### ANEKSI 2

Formati i Opinionit ligjor të Këshilltarit Ligjor të Huamarrësit (Shteti)

Formati i Opinionit Ligjor të Këshilltarit Ligjor të Huamarrësit (Shteti)

Shënim: Jeni të lutur të ndryshoni “Republika e VENDIT”/”VENDI “ përkatësisht.

[Koka e letrës së Këshilltarit Ligjor]

Faqe | 2886

KfW-ja \_\_\_\_\_

Departamenti [\_\_\_\_\_] (datë)

Në vëmendje të: [\_\_\_\_\_]

Palmengartenstrasse 5 - 9

Postfach 11 11 41

60325 Frankfurt am Main/Germany

Republika Federale e Gjermanisë

Marrëveshje Huaje e datës \_\_\_\_\_ e lidhur ndërmjet KfW-së dhe [\_\_\_\_\_] (Huamarrësit) për një shumë që nuk i kalon në tërësi \_\_\_\_\_000.000 euro,--.

Të nderuar Zotërinj,

Unë jam (Ministri i Drejtësisë së) (këshilltari ligjor) (drejtuesi i departamentit juridik të .... (jeni të lutur të specifikoni ministrinë ose autoritetin tjetër) të) Republika e VENDIT. Unë kam vepruar në këtë cilësi në lidhje me Marrëveshjen e Huas (Marrëveshja e Huas), të datës ...., të lidhur ndërmjet Huamarrësit, (...) dhe jush mbi një hua që duhet të jepet prej jush tek Huamarrësi në një shumë që nuk kalon në tërësi \_\_000.000,- Euro.

1. Dokumentet e shqyrtuara

Unë kam shqyrtuar :

1.1 një kopje origjinale autentike të Marrëveshjes së Huas;

1.2 dokumentet kushtetuese të Huamarrësit, veçanërisht:

a) Kushtetutën e Republikës së VENDIT, datë ....., të publikuar rregullisht në ....., nr. ...., faqe ....., e ndryshuar;

b) Ligjin(et) nr. .... datë ....., të publikuar rregullisht në ....., nr. ...., faqe ....., i ndryshuar [jeni të lutur të përshini, sipas rasti, ligjet (p.sh. ligjet e buxhetit) në lidhje me Huamarrjen nga Republika e VENDIT];

c)..... [jeni të lutur t'u referoheni dokumenteve të tjerë, p.sh. dekreteve ose rezolutave të organeve qeveritare ose administrative të VENDIT në përgjithësi ose mbi përfundimin e Marrëveshjes së Huas]; dhe

d) Marrëveshjen e Bashkëpunimit Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së VENDIT dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të datës ..... (Marrëveshje Bashkëpunimi)

dhe ligje, rregullore, certifikata, regjistra, regjistrime dhe dokumente të tjera dhe kam kryer ato hetime që i kam konsideruar të nevojshme ose të dëshirueshme për qëllimin e dhënies së këtij opinionit.



## 2. Opinioni

Për qëllimin e nenit ..... të Marrëveshjes së Huas, unë jam i mendimit se sipas ligjeve të republikës së VENDIT të kësaj datë:

2.1 Në pajtim me nenin ..... të Kushtetutës/neni ..... të Ligjit mbi ..... [jeni të lutur të specifikoni sipas rastit] Huamarrësi ka të drejtë të lidhë Marrëveshjen e Huas dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas, veçanërisht nëpërmjet :

a) Ligjet(eve) nr. .... datë ..... të parlamentit të Republikës së VENDIT, që ratifikon Marrëveshjen e Huas/aprovon nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi / ..... [jeni të lutur të plotësoni sipas rastit];

b) Vendimin(et) nr. .... datë ..... të Kabinetit të Ministrave/të komitetit të huave shtetërore / ..... [jeni të lutur të plotësoni organet qeveritare ose administrative të VENDIT, sipas rastit];

c) ..... [jeni të lutur t'u referoheni rezolutave, vendimeve etj.].

2.2 Znj./Z. .... (dhe znj./z. ....) është (janë) të autorizuar nga ..... [p.sh ligjërisht për shkak të pozicionit të saj/tij (si Ministër i ...../ si .....), me vendim qeverie, ....., me prokurë ..... datë ....., etj.] për të nënshkruar vetëm / bashkërisht Marrëveshjen e Huas në emër të Huamarrësit. Marrëveshja e Huas e nënshkruar nga znj./z. .... dhe znj./z. ....) është nënshkruar rregullisht në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim ligjërisht detyrues të Huamarrësit të ekzekutueshëm ndaj tij ligjërisht, në pajtim me kushtet e tij.

[Alternativa 1 për seksionin 2.3 që duhet të përdoret, nëse janë bashkë me dokumentet e specifikuar në seksionin 2.1 dhe 2.2, autorizime të caktuara zyrtare etj., të cilat duhet të merren sipas ligjeve të Republikës së VENDIT:]

2.3 Për nënshkrimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim përfundimin dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave të kërkueshme në monedhat e specifikuar), aprovimet, autorizimet, licencat, regjistrimet dhe/ose pëlqimet e nevojshme zyrtare janë marrë dhe janë plotësisht në fuqi:

a) Aprovimi i ..... [Bankës Qendrore /Bankës Kombëtare/.....], datë ....., nr. ....;

b) Pëlqimi i ..... [Ministër/Ministria e .....], datë ....., nr. ....; dhe

c)..... [jeni të lutur të rendisni çdo Autorizim licence dhe/ose aprovim zyrtar].

Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim zyrtar tjetër i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/kombëtare të Republikës së (VENDIT) ose gjykatë nuk kërkohet dhe nuk është e këshillueshme në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave në monedhat e specifikuar) dhe vlefshmërinë dhe ekzekutueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas,

ose

[Alternativa 2 për seksionin 2.3 që përdoret vetëm si shtesë e dokumenteve të specifikuar në seksionin 2.1 dhe 2.2, asnjë autorizim zyrtar nuk duhet të merret sipas ligjeve të Republikës së VENDIT:]

2.3 Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim zyrtar tjetër i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/kombëtare të Republikës së VENDIT) ose gjykatë nuk kërkohet dhe nuk është e këshillueshme në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave në monedhat e specifikuar) dhe vlefshmërinë dhe ekzekutueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

2.4 Asnjë taksë pulle apo taksë apo detyrim i ngjashëm nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e Marrëveshjes së Huas.

2.5 Zgjedhja e ligjit gjerman për të rregulluar Marrëveshjen e Huas dhe paraqitja për arbitrazh në pajtim me nenin ..... të Marrëveshjes së Huas janë të vlefshme dhe detyruese. Vendimet e arbitrazhit ndaj Huamarrësit janë të njohura dhe të ekzekutueshme në Republikën e VENDIT në pajtim me rregullat e mëposhtëm: ... (jeni të lutur të plotësoni traktatin e zbatueshëm (sipas rastit), p.sh., Konventa e Nju-Jorkut e vitit 1958, dhe/ose





parimet bazë në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit në VEND).

2.6 Gjykatat e Republikës së VENDIT kanë të drejtë të japin vendime të përcaktuara në monedhën ose monedhat e specifikuara në Marrëveshjen e Huas.

2.7 Huamarrja nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes së Huas dhe nënshkrimi dhe përmbushja nga Huamarrësi i Marrëveshjes së Huas përbëjnë veprime juridike private dhe tregtare dhe jo veprime juridike qeveritare ose publike. As Huamarrësi dhe as pasuria e tij nuk ka të drejtën e imunitetit nga arbitrazhi, padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose procese të tjera ligjore.

2.8 Marrëveshja Bashkëpunimit është në fuqi të plotë sipas kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së VENDIT. (Në pajtim me nenin 3 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.) (Nëse Marrëveshja e Bashkëpunimit nuk ka hyrë në fuqi por nuk ekziston një marrëveshje e tatimit të dyfishtë.) Në pajtim me ..... (jeni të lutur të specifikoni traktatin ose ligjet dhe rregulloret e zbatueshme)/ Huamarrësit nuk i kërkohet të kryejë ndonjë zbritje ose ndalim nga ndonjë pagesë që Huamarrësi duhet të bëjë sipas Marrëveshjes së Huas dhe nëse kjo zbritje ose ndalesë duhet të vendoset më vonë, dispozitat e nenit ..... të Marrëveshjes së Huas zbatohen për t'i kërkuar huamarrësit të zhdëmtojë KfW-në sipas rregullave.

2.9 KfW-ja nuk është dhe nuk konsiderohet të jetë rezidente, me banim, të zhvillojë biznes ose t'i nënshtrohet tatimit në Republikën e VENDIT për

shkak vetëm të nënshkrimit, përmbushjes ose ekzekutimit të Marrëveshjes së Huas. Nuk është e nevojshme ose e këshillueshme që KfW-ja të jetë e licencuar, e kualifikuar ose me të drejta të tjera të zhvillojë biznes ose që KfW-ja të emërojë agjentë ose përfaqësues në Republikën e VENDIT.

Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të drejtpërdrejta dhe pa kushte të Huamarrësit, të cilat janë të ekzekutueshme ndaj Huamarrësit në pajtim me kushtet e tyre përkatëse.

Ky opinion ligjor është i kufizuar për ligjet e Republikës së vendit.

\_\_\_\_\_ (vendi) \_\_\_\_\_ (data)

[Nënshkrimi]

Emri: \_\_\_\_\_

Bashkëlidhur:

Shënim. Jeni të lutur të bashkëlidhni fotokopje të vërtetuara të dokumenteve dhe dispozitave ligjore të përmendura më sipër (në lidhje me ligjet me tekst të gjatë ose Kushtetutën e Republikës së VENDIT, një kopje e dispozitave përkatëse do të ishte e mjaftueshme) dhe t'i jepni KfW-së një përkthim të vërtetuar në anglisht ose gjermanisht të secilit prej dokumenteve të mësipërme, nëse ky dokument nuk është lëshuar në anglisht ose gjermanisht si gjuhë zyrtare, përveç rasteve kur KfW-ja jep pëlqimin dhe për një gjuhë tjetër.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë